



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 02.04.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Ekziston konflikti i interesit në rastin me Nr. Protokoli: APK-DPKI-06/01-1107/24, për zyrtarin e lartë z. Përparim Rama, pasi që i njëjti në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, duke nënshkruar kontratën me titull: “Organizimi i festivalit Sunny Hill” Bashkëfinancim - me negocim” me Operatorin Ekonomik “The Sunny Hill” Sh.P.K., me pronar z. D.L., ka rënë ndesh me neni 6, nenin 17, lidhur me nenin 3, paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, 1.6 dhe 1.12, si dhe nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
- II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, do të inicioi procedurën kundërvajtëse në gjykatën kompetente.
- III. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka filluar trajtimin e rastit me Nr. prot. APK-DPKI-06/01-1107/24, pas informatës (denoncimit) nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të mundshëm të interesit dhe disa pretendime tjera që nuk hynë në fushën e konfliktit të interesit, dhe janë jashtë mandatit të Agjencisë pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë):

“[...]Lidhjet personale dhe biznesore. Përveç kësaj, ka lidhje të dyshimta mes Perparim Ramës dhe D. L., përfshirë dhënien e lejes ndërtimi në vitin 2021 dhe miratimin e saj në korrik 2023, gjatë mandatit të tij si kryetar dhe pas lidhjeve biznesore me babain e D. L. në Londër. Për më tepër, në vitin 2021, kur Perparim Rama ishte në detyrë si Kryetar, D. L./D. L. ka aplikuar për një leje ndërtimi në Angli në korrik 2023, e gjitha gjatë mandatit të Perparim Ramës. Kjo lidhje biznesore me babain e D. L. në Londër. Kjo lidhje dhe proces i lejes ndërtimi në Angli ngjallin dyshime për konflikt interesi. [...]”

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka mbledh informata të nevojshme lidhur me rastin dhe e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Përparim Rama lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (*shkresa zyrtare: APK-DPKI-06/01-1107/24*).

Më pas, me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të kësaj situate është mbajtur një takim me zyrtarin e lartë në fjalë, me ç' rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia lidhur me këtë rast. Në takim, zyrtari i lartë ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, e gjithashtu të njëjtat i ka përcjellur në Agjenci edhe në formë të shkruar.

Nga deklaratat në takim dhe ato të dërguara me shkrim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit nga zyrtari i lartë z. Përparim Rama (*shkresa zyrtare: DPKI-223/25*), theksohet se (*citojmë*):

“Sa i përket pyetjes lidhur me lidhjet afariste me z. D. L. si përfaqësues i “The Sunny Hill” Sh.P.K., brenda dhe jashtë vendit, ju njoftoj se i kam dizajnuar dy shtëpi të familjes Lipa në Londër. Kompania “4MA Group” ka nënshkruar kontratë me 05.11.2020, ndërsa pagesa e fundit është kryer 27.05.2022;

Ndërsa në përgjigjen tjetër është thënë se: Komuna e Prishtinës ka pasur kontratë për shërbime të organizimeve artistike, mirëpo kjo kontratë nuk ka përfshirë në objektin e saj edhe organizimin e festivalit “Sunny Hill”. Duhet theksuar sërish faktin që festivali “Sunny Hill” është i mbrojtur në kuptim të pronësisë intelektuale dhe asnjë operator tjetër ekonomik nuk mund të organizoj këtë festival përveç OE “The Sunny Hill” Sh.P.K. Prandaj, fakti që Komuna e Prishtinës ka pasur kontratë për organizime artistike nuk ndërlidhet asgjë me faktin që është kontraktuar OE “The Sunny Hill” Sh.P.K. për organizimin e festivalit “Sunny Hill” në Prishtinë. Kjo për arsye se të dy kontratat janë plotësisht të ndryshme në kuptim të objektit dhe qëllimit kontraktues”.

Nga informatat që përmban kërkesa e raportuesit të rastit, diskutimi nga takimi i mbajtur, duke përfshirë edhe deklaratat e zyrtarit të lartë z. Përparim Rama, dokumentacionit të siguruar sipas detyrës zyrtare nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, provat në dispozicion, si dhe sqarimet e dhëna në shkresat zyrtare me nr. protokoll: DPKI-06-223/25, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Më datën 24.07.2024, Kontrata me titull “Organizimi i festivalit Sunny Hill” Bashkëfinancim –me negocim”, nënshkruar nga Udhëheqësi i Sektorit të Prokurimi, Zyrtari Kryesor Administrativ, dhe përfaqësuesi i OE “The Sunny Hill” Sh.P.K.;

Me datë 05.11.2020, z. Përparim Rama, në kuadër të kompanisë së tij ‘4MA Group’, me seli në Londër, ka nënshkruar kontratë për projektin e shtëpisë së familjes D.L. (*shkresa zyrtare me nr. protokoll: DPKI-06-223/245*)

Me datë 27.05.2022, pagesa e fundit e realizuar lidhur projektin e kryer nga kompania ‘4MAGroup’ (*shkresa zyrtare me nr. protokoll: DPKI-06-223/25*).

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia konstatoi se, ekziston konflikti i interesit në rastin APK-DPKI-06/01-1107/24, për zyrtarin e lartë z. Përparim Rama, pasi që i njëjti në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, duke nënshkruar kontratën me titull: "Organizimi i festivalit Sunny Hill" Bashkëfinancim - me negocim" me Operatorin Ekonomik "The Sunny Hill" Sh.P.K., me pronar z. D.L., ka rënë ndesh me neni 6, nenin 17, lidhur me nenin 3, paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, 1.6 dhe 1.12, si dhe nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Fillimisht, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiq nga kjo vendimmarrje."

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

nënparagrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës."

si dhe nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definon nocionin vendimmarrje si:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Kurse, sa i përket veprimeve të ndaluara të zyrtarit, neni 9, paragrafi 1.8 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka përcaktuar se:

“Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime:

1.8 të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit”.

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të në një çështje të caktuar.

Në rastin konkret, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar se ekziston konflikti i interesit për faktin se zyrtari i lartë z. Perparim Rama nëpërmjet kompanisë së tij “4MA Group ka pasur marrëdhënie kontraktuale afariste në 5 vitet e fundit me D.L. - përfaqësues i autorizuar i subjektit ekonomik “The Sunny Hill” Sh.P.K. dhe përfitues i kontratës publike Nr: 616-24-7600-2-2-5/C1522, të nënshkruar nga z. Perparim Rama, përkatësisht, nga periudha e përmbushjes së kontratës mes z. Perparim Rama (pronar i 4MA Group) dhe klientit D.L., që konsiderohet pagesa e fundit për këtë qëllim e datës 27.05.2022 (shkresa zyrtare me nr. protokoll: DPKI-223/25), e deri tek nënshkrimi i kontratës publike Nr: 616-24-7600-2-2-5/C1522, me datë 24.07.2024, i Kryetarit të Prishtinës z. Perparim Rama, nuk kanë kaluar më shumë se pesë (5) vjet, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Prandaj, siç është konstatuar më lartë, zyrtari i lartë z. Perparim Rama ka marr pjesë në vendimmarrje, duke nënshkruar kontratën me titull: “Organizimi i festivalit Sunny Hill” Bashkëfinancim-me negocim”, me përfaqësuesin e OE “The Sunny Hill” Sh.P.K., datë 24.07.2024, me të cilin ka pasur marrëdhënie kontraktuale afariste në 5 vitet e fundit, nëpërmes kompanisë së tij “4MA Group”, duke plotësuar kështu edhe kushtin tjetër kumulativ, që është **ekzistimi i interesit privat i personit të afërt me të, përkatësisht, përfitimi i çfarëdo përparësie për organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste**, kësisoj është gjendur në situatë të konfliktit të interesit, duke rënë ndesh me neni 6, nenin 17, lidhur me nenin 3, paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, 1.6 dhe 1.12, si dhe nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, andaj Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij Vendimi.

II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me konstatimet për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.8, të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, do ta procedoj rastin në Gjykatën kompetente, konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;

III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë”*, si


dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Mbështetur në dispozitat e nenit 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit [Përgjegjësitë e Agjencisë], si dhe nenit 2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit [Fushëveprimi], Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, nuk është lëshuar në trajtimin e pretendimeve tjera të ngritura nga raportuesi i rastit, të cilat pretendime nuk hynë në sferën e konfliktit të interesit, përkatësisht janë jashtë mandatit dhe kompetencave ligjore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


YLLI BULESHKAJ
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit